



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Prizemir Me Data 21-10-2025			
Nr. Llogarit Org. Breg	Numri Breg	Shtetëro Përdor	Vlera Vrednost
02-	199/01-	4649	



KOMUNA E VITISË
OPŠTINA VITINA
MUNICIPALTY OF VITINA

Në bazë të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtar Publik, nenit 95, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Rregullores QRK Nr.27/2024 për Proceduarat e Konkurrimit për Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës, nenit 5 dhe 6, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore shpallë këtë :

KONKURS PUBLIK

Institucioni:

Komuna e Vitisë

Drejtoria:

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale -QKMF

Titulli i vendit të punës:

1 (një) pozitë punëtor teknik-lavandaris (rrobalarës-e) në QKMF

Titulli i vendit të punës:

2 (dy) pozita Vozitës në QKMF

Lloji i pozitës:

Nëpunës teknik dhe mbështetës

Koeficienti

GJ51 - 3.76

Koeficienti

GJ50 - 3.8

Kohëzgjatja e kontratës:

Në kohë të pacaktuar

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e stafit administrativ dhe mbështetës:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e punës - puntor teknik - lavandaris (rrobalarës-e):

- Është përgjegjes për mirëmbajtjen e lavandarisë
- Bënë pastrimin dhe hekurosjen e uniformave të stafit mjeksor, qarqafëve,.
- Mban higjienën dhe kujdeset për inventarin në vendin e punës,
- Bënë kërkes për mjetet e nevojshme higjienike dhe i pranon ato,
- Të kryej edhe punë të tjera që i cakton udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë,
- Për punën e vet i përgjigjet përgjegjësit dhe drejtorit të QKMF-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e punës - Vozitës në QKMF :

- Drejton automjetin sipas nevojës dhe urdhërit të mbikëqyrësit, si dhe kujdeset për automjetin me të cilin është i ngarkuar.
- Është përgjegjes për mirëmbajtjen e automjetit, larjen, dhe evidentimin e prishjeve etj.
- Mban higjienën dhe kujdeset për automjetet e tjera të QKMF-së sipas orarit të punës përmes mbikëqyrësit të autoparkut,
- Përgjigjet për automjetin dhe pajimet e tij,

- Në fletëdhëtimet regjistron numrin e kilometrave të kaluara në udhëtim dhe shënimet tjera të cilat kërkohen.
- Të kryej edhe punë të tjera që i cakton udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë,
- Për punën e vet i përgjigjet përgjegjësit dhe drejtorit të QKMF-së.

Kualifikimi dhe përvoja për puntor teknik - lavandaris (rrobalarës-e):

- Të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Të ketë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip ;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion.

Kualifikimi dhe përvoja për pozitën - Vozitës në QKMF

- Të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Patent Shoferi kategoria B,
- Përvoja e punës : Një (1) vit përvojë pune në vozitje,
- Të ketë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip ;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Formulari i aplikimit, i plotësuar.
- Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë).
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (dorëzohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur).
- Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse (dorëzohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim).
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj, dorëzohet pas përzgjedhjes).
- Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për shkelje të rënda të pushuar sipas Ligjit për Zyrtarët Publik.
- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit).
- Kopjet e dëshmisë së punësimit nëse ka.
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve nëse ka.

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve: a. Vlerësimi i jetëshkrimit (deri në 30 pikë)
b. Intervistë me gojë (deri në 70 pikë)


“Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në LZP”.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Afati për pranimin e aplikacioneve është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga shpallja e procedurës.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në Zyrën e Arhivës të Komunës së Vitisë, kati përdhësë në ndërtesën e Administratës së Komunës së Vitisë si dhe mund të shkarkohet nga web-faqja zyrtare e Komunës së Vitisë. <https://viti.rks-gov.net/konkurset-njoftimet>. dhe <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Arhivës apo të dërgohen me postë në këtë adresë: Komuna e Vitisë, Rr. "Hasan Kabashi" pa Nr. Viti.

Rezultatet shpallën në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe <https://viti.rks-gov.net/konkurset-njoftimet>.



Udhëheqësi i NjMBNj

Hysen Ymeri